



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals



Në pajtim me nenin 24 paragrafi 4, nenit 34 paragrafi 4, nenit 41 paragrafi 4, nenin 56, nenit 69, nenin 59 paragrafi 1 dhe nenin 62 të Ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet si dhe nenit 34 të Ligjit Nr.04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-163 për Miniera dhe Minerale, Bordi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale në mbledhjen e mbajtur më datë 03/03/2016 nxjerr këtë;

UDHËZIM ADMINISTRATIV

(KPMU. UA. Nr. 02/2016)

PËR MBIKQYRJEN DHE INSPEKTIMIN E BARTËSVE TË LICENCAVE QË USHTROJNË AKTIVITETE MINERARE

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është rregullimi i mbikëqyrjes dhe inspektimit të bartësve të licencave të lëshuara nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (në tekstin e mëtejme KPMU), të cilët ushtrojnë aktivitete minerare.

Neni 2

Fushëveprimi

2. Ky Udhëzim Administrativ zbatohet nga KPMU për mbikëqyrjen dhe inspektimin e bartësve të licencave për licencat e lëshuar sipas Ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet si dhe nenit 34 të Ligjit Nr.04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-163 për Miniera dhe Minerale dhe me të përcaktohen procedurat, mënyrat, format, afatet dhe kohëzgjatja e mbikëqyrjes dhe inspektimit.

3. Mbikëqyrja dhe inspektimi i bartësve të licencave kryhet nga KPMU-ja me qëllim që të sigurohet që operimet minerare të jenë në pajtueshmëri me ligjin, aktet nënligjore të nxjerra në pajtim me ligjin dhe kushtet dhe afatet e licencave dhe lejeve të lëshuara nga KPMU.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë këtë kuptim:

- 1.1. **KPMM**- nënkupton Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale;
- 1.2. **Bartës i licencës** – personi ose personat e emëruar dhe të autorizuar në bazë të licencës;
- 1.3. **Mbikëqyrja** – nënkupton procesin e shqyrtimit dhe kontrollimit të të gjitha punëve të cilat kryejnë bartësit e licencave që kanë të bëjnë me fushë veprimtarin minerare në kuadër të licencës që posedojnë, duke përfshirë këtu kontrollimin e raporteve periodike vjetore, mbikëqyrjen në vendin e punës etj.
- 1.4. **Inspektimi minerar** – nënkupton procesin e inspektimit të punëve minerare nga zyrtarët e autorizuar për të verifikuar nëse punët dhe aktivitetet minerare janë në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi dhe licencën apo lejen e punës.
- 1.5. **Vendi i punës** – nënkupton vendin ku bartësi/bartësit e licencës e zhvillojnë aktivitetin e tyre duke përfshirë të gjitha objektet ndërtimore por edhe ato mekanike dhe mjetet tjera të punës.
- 1.6. **Komisioni i inspektimit** – nënkupton komisionin e përbërë nga inspektori dhe grupin e zyrtareve të autorizuar nga drejtori i KPMM-së që kryejnë mbikëqyrjen dhe inspektimin.
- 1.7. **Plani dhe programi i punës** – nënkupton planin dhe programin e hartuar nga komisioni për inspektim me të cilin përcaktohen se si do të kryhet inspektimi duke përfshirë fazat e inspektimit, mënyrën e inspektimit, personat që do të marrin pjesë në inspektim dhe detyrat që do të kryejnë.

Neni 4

Autorizimi i Komisionit të Inspektimit

Komisionet e inspektimit në kuadër të KPMM-së janë të autorizuar për kryerjen e mbikëqyrjes dhe inspektimit të bartësve të licencave, autorizimet e tyre rrjedhin nga Ligji nr.03/L-163 për Miniera dhe Minerale sipas të cilit inspektorët kanë për detyrë mbikëqyrjen

dhe inspektimin e aktiviteteve minerare, për të siguruar pajtueshmërinë me Ligjet në fuqi dhe me kushtet e Licencës apo Lejes së dhënë nga KPMM.

Neni 5

Përgjegjësitë e KPMM-së

1. KPMM në procesin e inspektimit ka përgjegjësitë të cilat përfshijnë por nuk kufizohen me si vijon:

- 1.1. Të njoftoj me shkrim bartësin e licencës se do të bëhet inspektimi 10 (dhjetë) ditë para fillimit të inspektimit dhe kërkon që të bëhen përgatitjet e nevojshme për inspektim.
- 1.2. Kryetari i komisionit të hartoj planin dhe programin e inspektimit duke parapare detyrat e komisionit të inspektimit dhe të sigurohet që i njëjti të bëhet në përputhje me ligjet në fuqi.
- 1.3. Të mbajë shënimet lidhur me çdo fazë të inspektimit, të gjitha dokumentet e inspektuara dhe për të gjitha vërejtjet dhe shkeljet që i konstaton.
- 1.4. Të regjistroj të gjitha inspektimet e bëra dhe të mbajë raporte për çdo inspektim të kryer.
- 1.5. Të koordinohet me organet e tjera shtetërore për të realizuar inspektimin, kur natyra e inspektimit kërkon një koordinim të tillë.

Neni 6

Përgjegjësitë dhe detyrat e bartësve të licencave

1. Bartësit e licencave kanë përgjegjësitë e tyre në procesin e inspektimit, të cilat përfshijnë por nuk kufizohen me përgjegjësitë si vijon:

- 1.1. Të kontaktojnë organin kompetent pasi iu dërgohet njoftimi për inspektim dhe paraprakisht të koordinojnë inspektimin.
- 1.2. Të sigurojnë që puna është gati për inspektim në kohën e përcaktuar për inspektim.
- 1.3. Sigurojnë të gjitha dokumentet e nevojshme për inspektim që të gjitha të jenë në vendin e punës dhe të gatshme për tu inspektuar,
- 1.4. Ofrohet qasje në inspektimin e minierës dhe të gjitha mjeteve të punës.

- 1.5. Njoftimin e organit kompetent në raste kur ka aksidentet në punë, lëndimin e të punëtoreve etj.

KAPITULLI II

FORMAT DHE MËNYRAT E MBIKËQYRJES DHE INSPEKTIMIT

Neni 7

Forma dhe mënyra e mbikëqyrjes

Mbikëqyrja dhe kontrolli bëhet mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur. Kjo formë e mbikëqyrjes realizohet nga KPMM përmes departamenteve përkatëse të cilat janë të obliguara të shqyrtojnë raportimet periodike të bëra nga bartësit e licencave të cilët janë të obliguara të raportojnë në bazë të Ligjit Nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale si dhe nenit 34 të Ligjit Nr.04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-163 për Miniera dhe Minerale.

Neni 8

Forma dhe Mënyra e Inspektimit

1. Inspektimi i bartësve të licencave bëhet në vendin e punës (vend shfrytëzimin apo vend hulumtimin) dhe është inspektim i rregullt mbi të gjitha aktivitetet e punës që kryhen nga bartësit e licencave apo lejeve.
2. Inspektimi i bartësve të licencave apo lejeve në vendin e punës bëhet nga komisionet për inspektim të përbëra me nga një anëtar apo me shumë anëtar nga Departamentet përkatëse, Inspektorati, Gjeologjia, Gjeodezia, dhe Financa (të Hyrat) dhe sipas nevojës mund të marr pjesë edhe ndonjë anëtar tjetër.
3. Në raste të caktuara kur departamenti përkatës duke u bazuar në specifikat e punës e parashihet të nevojshme mund të caktoj më shumë se një anëtar në komision.

Neni 9

Programi dhe Plani i inspektimit

1. Kryeinspektori dhe udhëheqësit e departamenteve tjera në kuadër të KPMM-së të cilat janë kompetente për inspektimin e aktivitete minerare në Kosovë, në mënyrë të koordinuar çdo fillim viti hartojnë planin e përbashkët vjetor të inspektimeve të rregullta dhe ia paraqesin atë drejtorit të KPMM-së për aprovim.

2. Komisionet për inspektimin e bartësve të licencave emërohen nga drejtori i KPMM-së me propozimet e udhëheqësve të departamenteve përkatëse.
3. Çdo komision duhet të ketë kryetarin e komisionit i cili duhet të jetë prej departamentit të inspektoratit dhe të paktën 3 (tre) anëtarë nga këto departamente: Gjeologjia, Financat dhe Gjeodezia, kurse sipas nevojës mund të marr pjesë edhe ndonjë anëtar tjetër.
4. Kryetari i komisionit pasi të emërohen është i obliguara që të hartojnë planin e përbashkët të veprimit dhe të bëjnë ndarjen e detyrave në mënyre që të arrihet inspektimi sa më shpejt dhe i suksesshëm duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-163 për Miniera dhe Minerale dhe këtë Udhëzim Administrativ.

Neni 10 **Llojet e inspektimit**

1. KPMM-ja kryen këto lloje të inspektimeve:

- 1.1. Inspektimet e Aktiviteteve Minerare nga Inspektorati i Minierave;
- 1.2. Inspektimet e Aktiviteteve Minerare nga Departamenti i Gjeologjisë;
- 1.3. Inspektimet e Aktiviteteve Financiare nga Departamenti i Financave;
- 1.4. Inspektimet e Aktivitete Minerare nga Departamenti i Gjeodezisë;
- 1.5. Ndonjë inspektim tjetër që konsiderohet i nevojshëm sipas vlerësimit të KPMM-së, dhe mund të bëhet në ato raste kur parashihet me vendim të komisionit.

Neni 11 **Inspektimi i aktiviteteve nga Inspektorati i minierave**

1. Inspektimet e organizuara nga departamenti i inspektoratit ndahen në:

- 1.1. Inspektimin e minierave nëntokësore;
- 1.2. Inspektimin e minierave sipërfaqësore duke përfshirë edhe lejet për aktivitete të veçanta;

1.1. Gjatë inspektimit të rregullt në minierat me aktivitete nëntokësore kryhen këto kontrolle:

- a) Kontrollimi i gjendjes dhe sigurisë në punë,
- b) Kontrollimi i dokumentacionit teknik,

- c) Kontrollimi i projektit kryesor të shfrytëzimit,
- d) Kontrollimi i projekteve teknike,
- e) Kontrollimi i projekteve të thjeshtëzuara
- f) Verifikimi i fushës së shfrytëzimit në raport me kufijtë e licencës dhe parametrat projektuese,
- g) Kontrollimi i librave të mbikëqyrjes së makinerisë së makinave ngritëse,
- h) Kontrollimi i librave të mbikëqyrjes së ventilatorit kryesor,
- i) Kontrollimi i skuadrës së shpëtimit,
- j) Kontrollimi i depos kryesore të eksplozivit,
- k) Kontrollimi i rrugëve të ajrimit
- l) Kontrollimi i librave për përcjellje të matjeve të mikroklimës,
- m) Kontrollimi i udhëzimeve të punës,
- n) Kontrollimi i afatit të ndërrimit të litarëve të makina ngritëse,
- o) Kontrollimi i vendimeve të punëtorëve,
- p) Kontrollimi i sistematizimit të punëtorëve,
- q) Kontrollimi i dokumentacionit të personelit teknik,
- r) Kontrollimi i kualifikimeve të punëtorëve në vendet e punës,
- s) Kontrollimi i dokumentacionit të shikimit sistematik mjekësor të punëtorëve,
- t) Kontrollimi i normativave dhe mjeteve të punës së punëtorëve,
- u) Kontrollimi i dokumentacionit të shikimit sistematik mjekësor të punëtorëve,
- v) Kontrollimi i banjës së punëtorëve,
- w) Kontrollimi i daljeve dytësore,
- x) Kontrollimi i vend punishteve,
- y) Kontrollimi i korridoreve dhe rrugëve transportuese,
- z) Kontrollimi i stacioneve të kompresorëve,
- aa) Kontrollimi i stacioneve të pompave,
- bb) Kontrollimi i trafo-stacioneve,
- cc) Kontrollimi i objekteve minerare- gjendja e sigurisë së tyre,
- dd) Kontrollimi i procesit të përpunimit-flotimit,

1.2. Gjatë inspektimit të rregullt në minierat me aktivitete sipërfaqësore kryhen këto kontrolle:

- a) Kontrollimi i gjendjes dhe sigurisë në punë,
- b) Kontrollimi i dokumentacionit teknik,
- c) Kontrollimi i projektit kryesor të shfrytëzimit,
- d) Kontrollimi i projekteve teknike,
- e) Kontrollimi i projekteve të thjeshtëzuara
- f) Verifikimi i fushës së shfrytëzimit në raport me kufijtë e licencës dhe parametrat projektuese,

- g) Kontrollimi i librave të mbikëqyrjes së ekskavatorëve dhe mekanizmit tjetër në procesin e shfrytëzimit,
- h) Kontrollimi i udhëzimeve të punës,
- i) Kontrollimi i gardërobës së punëtorëve,
- j) Kontrollimi i sistematizimit të punëtorëve,
- k) Kontrollimi i dokumentacionit të personelit teknik,
- l) Kontrollimi i kualifikimeve të punëtorëve në vendet e punës,
- m) Kontrollimi i dokumentacionit të shikimit sistematik mjekësor të punëtorëve,
- n) Kontrollimi i normativave dhe mjeteve të punës së punëtorëve,
- o) Kontrollimi i banjës së punëtorëve,
- p) Kontrollimi i vend punishteve,
- q) Kontrollimi i mekanizmit- gjendja teknike e mjeteve dhe veglave të punës,
- r) Kontrollimi i procesit të përpunimit.

Neni 12

Inspektimi Gjeologjik

1. Inspektimi gjeologjik- është pjesë e inspektimit të rregullt të aktiviteteve dhe hulumtimeve gjeologjike dhe shfrytëzimit të mineraleve nga bartësit e licencave.

2. Gjatë inspektimit gjeologjik kryhen kontrollet si në vijim:

- a) Inspektimi se a i plotëson kushtet e parapara me licencë, për hulumtimet e bëra.
- b) Shpimet e bëra;
- c) Shtresat e shpuara të tokës, me shënime të hollësishëm të tyre,
- d) Resurset minerale të identifikuara,
- e) Rezultatet e të gjitha studimeve gjeologjike, gjeokimisë dhe gjeofizike,
- f) Rezultatet e të gjitha analizave ose identifikimeve të mineraleve,
- g) Interpretimin gjeologjik të të dhënave të marra në bazë të nen paragrafëve a) deri d),
- h) Veprimtaritë tjera të kryera nga i licencuari dhe që kanë të bëjnë me programin për hulumtime dhe projektin e shfrytëzimit,
- i) Ruajtjen dhe mirëmbajtjen në kushte të mira, secilën mostër kryesore të marre në bazë të licencës në mënyrën që qartazi të identifikohet data dhe vendi i nxjerrjes së saj,
- j) Kopjet e të gjitha hartave, të raporteve gjeologjike, duke përfshirë interpretimet, kopjet e analizave të xeheve, të fotografive nga ajri, librave të shënimeve për

xehet, të analizave e të testeve dhe të gjitha të dhënat e tjera të marra dhe të përpiluara nga bartësi i pajisur me licence përkitazi me zonën e shfrytëzimit-xehetarisë.

- k) Inspektimin e hulumtimeve të detajuara gjeologjike në bazë të hulumtimeve paraprake gjeologjike
- l) Inspektimin e hulumtimeve të detajuara gjeologjike të lëndës së parë minerale dhe të terrenit për ndërtim, në bazë të lejes për hulumtime dhe në pajtim me të.
- m) Hartimin e projektit dhe elaboratin e kërkimeve gjeologjike dhe të kontrollit teknik, përkatësisht kryerjen e organizimeve të kërkuara.
- n) Inspektimin e punëve hulumtuese sipas projektit dhe programit të hulumtimeve gjeologjike të paraqitur.
- o) Inspektimin e udhëheqjen nga personat të cilët i plotësojnë kushtet e parapara për kryerjen e punëve hulumtuese si dhe aftësitë e punëtorëve për punët që kryejnë.
- p) Inspektimin e punëve hulumtuese në hapësirat e lejuara.
- q) Inspektimin e hulumtimeve gjeologjike duke respektuar masat e caktuara teknike, normativat e standardeve dhe metodave bashkëkohore të shkencës së gjeologjisë.
- r) Inspektimin e mbajtjes së librave të evidencave mbi sasitë e nxjerra të lëndëve të para minerale, qëllimi i shfrytëzimit të lëndëve të para si dhe evidentimi i xeheroreve tjera ekzistenca e të cilave është verifikuar.
- s) Inspektimin se a është tejkaluar sasia e lejuar e mineraleve për hulumtim dhe inspektimin se minerale të nxjerra gjatë punëve kërkimore a kalojnë në shfrytëzim.
- t) Mbajtja e librit mbi gjendjen e rezervave të lëndëve të para minerale.
- u) Mbajtja e dokumentacionit të nevojshëm gjeologjik mbi punët e kryera hulumtuese dhe mbajtja e tyre në pajtim me këtë akt nënligjor.

Neni 13

Inspektimi Financiar

1. Inspektimi financiar është pjesë e inspektimit të rregullt të kompanive që ushtrojnë aktivitete minerare dhe janë të licencuara, këto inspektime fokusohen në:

- a) Shënimet financiare që lidhen me punën e aktiviteteve minerare dhe librat e llogarive apo shënimet të tjera financiare.
- b) Gjendjen financiare të subjektit që është bartës i licencës dhe aftësinë e tij pages për shlyerjen e borxheve,
- c) Pagesën e rentës minerare dhe respektimin e marrëveshjes për pagesën e rentës (nëse ka marrëveshje),

- d) Inspektimin e procedurës së shitjes së mineralit të caktuar, për të cilin kompania ka licencë,
- e) Dëshmi për sasinë e shfrytëzuar të mineralit për të cilën ka licencë,
- f) Kontrollimin e shpenzimeve operative dhe shpenzimeve për investime,
- g) Saktësinë e llogaritjes së sasisë së shitur dhe përfitimeve sipas kontratës së caktuar dhe krahasimin me raportin periodik,
- h) Identifikimin e transaksioneve në mes të kompanive apo shoqërive tjera tregtare,
- i) Identifikimin e ndonjë problemi financiar.

Neni 14 **Inspektimi Gjeodezik**

1. Inspektimi gjeodezik- është pjesë e inspektimit të rregullt të kompanive që ushtrojnë aktivite minerare dhe që janë të licencuara, ky lloj i inspektimit fokusohet në këto inspektime:

- a) Inspektimin dhe kontrollimin e kufijve të zonës së licencimit me saktësi të lartë,
- b) Matjen dhe pasqyrimin e situacionit të terrenit sipas shkalleve të zvogëlimit që janë kërkuar,
- c) Inspektimi i pikave gjeodezike nëntokësore,
- d) Matjen e sasive të shfrytëzuara të lëndëve minerale,
- e) Inspektimet e tjera gjeodezike të nevojshme.

Neni 15 **Inspektimet e jashtëzakonshme**

1. Kur ka informacione apo dyshohet se bartësi i licencës është duke kryer veprimtari në kundërshtim me Ligjin Nr.03/L-163 për Miniera dhe Minerale (i ndryshuar me Ligjin Nr.04/L-158), KPMM ka të drejtë të bëjë inspektime të jashtëzakonshme, dhe pa paralajmërim.

2. Inspektimet e jashtëzakonshme nga ana e Inspektoratit të KPMM-së mundë të kryhen, me inicim nga ana e Bordit të KPMM-së, Drejtorit, Kryeinspektorit ose edhe nga Prokuroritë e shtetit dhe OJQ-të.

KAPITULLI III **DISPOZITAT TJERA**

Neni 16

Kohëzgjatja e inspektimit

1. Inspektimet duhet të kryhen në mënyre efikase me qëllim që të kryhen për kohë sa më të shkurtër dhe të zvogëlohet qëndrimi i gjatë në vendshfrytëzim.
2. Koha e inspektimit përcaktohet në bazë të planit të inspektimit në varësi nga kushtet e licencës dhe aktiviteti minerar i bartësit të licencës dhe specifikohen në vendimin për inspektim.
3. Komisioni i përcaktuar për inspektim duhet të kryej punë intensive çdo ditë në mënyrë që inspektimi të kryhet për kohë sa më të shkurtër.
4. Koha e inspektimit mund të zgjatet në raste kur nuk janë arritur objektivat e përcaktuara me planin e inspektimit.

Neni 17

Realizimi i inspektimit

1. Komisioni i inspektimit do të realizoj inspektimet në ditët e planifikuara. Nëse brenda atyre ditëve nuk arrihet të kryhet i gjithë inspektimi atëherë në përputhje me nenin 15 paragrafi 4 të këtij Udhëzimi Administrativ mund të vazhdohet për një afat shtesë deri në realizimin e plotë të inspektimit.
2. Komisioni i inspektimit pas kryerjes së inspektimit do të jep një raporte pozitiv në rast se aktivitetet minerare dhe puna nga ana e bartësit të është kryer në pajtueshmëri me ligjin dhe me licencën apo lejen.
3. Nëse gjatë inspektimit bartësi i licencës nuk i është përmbajtur rregullave dhe kritereve të parapara me ligj, licencë apo leje, komisioni i inspektimit në raport i paraqet vërejtjet e veta dhe i kërkon bartësit të licencës që të bëhen përmirësimet e nevojshme dhe të evitohen shkeljet e bëra.

Neni 18

Numri i inspektimeve dhe plani vjetor i inspektimeve

1. Kryeinspektori është i obliguar të hartoj planin vjetor të inspektimeve në të cilin përcaktohen se cilat ndërmarrjet duhet të inspektohen, për plani e inspektimit duhet të njoftohet bordi dhe të aprovohet nga drejtori.

1.1. Në planin vjetor inspektorit përfshihen të gjitha ndërmarrjet apo licencat si në vijim:

1.2.1. Dhjetë 10 ndërmarrje apo licenca (nga 2 ndërmarrje apo licenca për secilin regjion) nga viti i dytë i marrjes së licencës deri në vitin e pestë 5.

1.2.2. Dhjetë 10 ndërmarrje apo licenca (nga 2 ndërmarrje apo licenca për secilin regjion) nga viti i fundit apo i parafundit i mbylljes së licencës

1.2.3. Se paku nga dy 2 ndërmarrje apo licenca me aktivitet të shfrytëzimit nëntokësorë;

1.2.4. Se paku nga dy 2 ndërmarrje apo licenca me aktivitet më të mëdha të prodhimit vjetor apo me sipërfaqe me të madhe të licencës.

2.. Në planin vjetor të inspektimeve ndërmarrjet sipas paragrafëve 4.2.3 deri në 4.2.5 duhet të planifikohet inspektimi brenda gjashtë 6 muajve të parë të vitit kalendarik dhe raportet e tyre të punohen para tremujorit të fundit me rekomandime, dhe para fund vitit të finalizohet raporti.

3. Në raste se nuk plotësohen kriteret e parapara me paragrafët 4.2 atëherë kryeinspektori aplikon sistemin e përzgjedhjes së ndërmarrjeve për inspektim në baza reale të përafërimit të kriterëve.

4. Në planin vjetor të inspektimeve drejtori me vendim mundet të shtoj numrin e ndërmarrjeve apo licencave për inspektim.

5. KPMM është e obliguar që brenda afatit të licencës të inspektoj ndërmarrjen të paktën një herë.

6. Planin Vjetor të Inspektimeve miratohet nga Bordi i KPMM-se.

Neni 19

Ndërprerja e Punimeve

1. Komisioni i inspektimit mund të lëshoj urdhër për ndërprerjen e aktivitetit minerar dhe punës së bartësit të licencës në rastet e mëposhtme:

- 1.1. Aktiviteti minerare dhe puna që është duke u bërë shkaktojnë rrezik të drejtpërdrejt shëndetit dhe sigurisë në punë;
- 1.2. Punët dhe aktivitetet minerare janë duke u bërë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe me licencën apo lejen;
- 1.3. Aktivitetet minerare janë duke u kryer jashtë sipërfaqes së licencës.
- 1.4. Kur komisioni pengohet nga bartësi i licencës apo ndonjë person i trete dhe nuk merren masat parandaluese nga bartësi i licencës ku duhet të bëhet inspektimi.

Neni 20

Procesverbali dhe Raporti i Inspektimit

1. Komisioni i inspektimit duhet të mbaj shënime në formë të procesverbalit gjatë kryerjes së inspektimit.
2. Pas përfundimit të inspektimit dokumenti përfundimtar që evidenton punën e bërë dhe rezultatet e inspektimit të ushtruar është Raporti i Inspektimit.
3. Draft raporti i inspektimit të kryer i dërgohet bartësit të licencës për komente lidhur me lëshimet eventuale.
4. Bartësi i licencës është i detyruar që brenda afatit 7 ditor ti jap komentet lidhur me draft raportin.
5. Komisioni i Inspektimit brenda afatit pesë (5) ditor pas marrjes së komenteve sipas paragrafit 4 të këtij neni, harton raportin final dhe të njëjtin ia dorëzon Drejtorit të KPMM-së.

Neni 21

Rekomandimet e Komisionit të Inspektimit

1. Komisioni duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, rezultatet e inspektimit dhe gjendjen reale të përcaktuar me raportin e inspektimit, në raportin final mund të jep këto rekomandime:

- a) Që lëshimet dhe të metat e konstatuara të eliminohen në afatin e caktuar nga Komisioni.
- b) Të ndërpritet puna deri në evitimin e vërejtjen.
- c) Të bëhet pezullimi apo marrja e licencës për shkak të shkeljeve esenciale të ligjit dhe kushteve të licencës.
- d) Bartësi i licencës të gjobitet për shkeljet e evidentuara.
- e) Të ndërpritet hulumtimet e mëtejme gjeologjike.

Neni 22

Gjobat Administrative

KPMM në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe Udhëzimin përkatës administrativ për gjoba administrative do të përcaktoj procedurat, mënyrat dhe lartësinë e gjobave për shkeljet e konstatuara.

Neni 23

Shqyrtimi i Ankesave

1. Të gjithë bartësit e licencave kanë të drejtë që të paraqesin ankesë ndaj vendimeve që merren në bazë të këtij Udhëzimin Administrativ.
2. Ankesa i drejtohet Drejtorit të KPMM-së për shqyrtim në afat prej 7 ditësh pas marrjes së vendimit.

Neni 24

Dispozitat Kalimtare

1. Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
2. Me hyrjen e fuqi të këtij udhëzimi administrativ shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr.003/KPMM/09 i datës 08.09.2009.

Musa Shabani

Kryesues i Bordit

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

